

**“Rregullore mbi zhvillimin e vijueshëm profesional të audituesve  
të brendshëm në sektorin publik”**  
**(Ndryshuar me Urdhërin Nr.47/1, datë 21.4.2014, të Ministrit të Financave).**

**I. Dispozita të përgjithshme**

**Neni 1**

Rregullorja e Trajnimit të Vijueshëm Profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik në Shqipëri (më poshtë: Rregullorja) miratohet në zbatim të nenit 10, të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm Publik”, të ndryshuar, Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe ka si qëllim të përcaktojë procedurat që duhet të ndiqen për programimin, organizimin, administrimin dhe dokumentimin e procesit të Trajnimit të Vijueshëm të Detyrueshëm. Rregullorja përcakton mënyrat dhe formën e trajnimit, identifikimin e nevojave për trajnim si dhe regjistrimin, ruajtjen dhe përditësimin e njohurive.

**Neni 2**

Audituesit e Brendshëm kanë detyrimin profesional :

- Të aplikojnë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e auditimeve;
- Të kryejnë auditimet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të pranuar, si dhe kuadrin ligjor dhe procedural për auditimin e brendshëm në Shqipëri;
- T’i nështrohen trajnimit sipas programit dhe normave të përcaktuara në Programin e Trajnimit të Vijueshëm të Detyrueshëm.

**Neni 3**

Të gjithë audituesit e brendshëm në detyrë pas marrjes së Dëshmisë “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, kanë detyrimin e përvitshëm që të zhvillojnë aftësitë dhe përvojën e tyre profesionale në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje, duke synuar rritjen e profesionalizmit në ushtrimin e funksionit dhe me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së punës audituese.

**II. Përkufizime**

**Neni 4**

1. **Auditues të Brendshëm të Çertifikuar në detyrë** për qëllime të kësaj rregulloreje janë të gjithë audituesit e brendshëm të cilët kanë fituar titullin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” dhe ushtrojnë funksionin e audituesit të brendshëm sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr.9720, datë 23.04.2007 “Mbi Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, të ndryshuar.
2. **Auditues të Brendshëm të Çertifikuar** për qëllime të kësaj rregulloreje janë të gjithë personat që kanë fituar titullin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, por nuk ushtrojnë funksionin e audituesit të brendshëm në njësitë e sektorit publik.

3. **Trajnim i Vijueshëm i Detyrueshëm** është formë e zhvillimit profesional e organizuar nga NJQH për AB çdo vit mbi bazë leksionesh me prezantime ose/dhe të kombinuar me raste praktike, temat dhe forma e të cilit përcaktohen në programin e hartuar për këtë qëllim. Kohëzgjatja e trajnimit të vijueshëm të detyrueshëm është jo më pak se 40 orë trajnimi në vit.
4. **Analiza e Nevojave për Trajnim** është procesi i identifikimit dhe vlerësimit të kërkesave mbi temat e trajnimit, aftësive dhe njohurive të nevojshme për ushtrimin e funksionit të audituesit të brendshëm në përputhje me standardet e punës.
5. **Regjistri i Audituesve të Brendshëm** është dokumentimi i të dhënave dhe informacionit lidhur me çertifikimin, trajnimin e vijueshëm të detyrueshëm dhe të dhëna të tjera mbi zhvillimin profesional të audituesve të brendshëm publik. Regjistri mbahet dhe administrohet nga NJQH për AB në formë elektronike dhe të shkruar "hard copy".

### **III. Organizimi dhe zbatimi i programit**

#### **Neni 5**

Audituesi i brendshëm duhet të zhvillojë dhe të ruajë standarde të larta të profesionit, nëpërmjet ndjekjes dhe pjesëmarrjes në trajnime çdo vit, sipas programit të miratuar dhe publikuar nga NJQH për AB. Pas çertifikimit si auditues të brendshëm publikë, audituesit e brendshëm në detyrë kanë detyrimin për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të njohurive dhe aftësive profesionale i cili përfshin si kufi minimal 80 orë trajnimi në dy vjet.

#### **Neni 6**

Audituesit e Brendshëm të Çertifikuar që nuk ushtrojnë këtë detyrë nuk janë domosdoshmërisht subjekt i Trajnimit të Vijueshëm të Detyrueshëm. Ata mund të trajnohen nga NJQH për AB vetëm me kërkesë të tyre dhe kundrejt pagesës së përcaktuar në një akt nënligjor të veçantë, pasi kjo e fundit vlerëson mundësitë e organizmit të trajnimit.

#### **Neni 7**

Njësia Qëndore e Harmonizimit bën Analizën e Nevojave për Trajnim bazuar në regjistrin e kualifikimit të vijueshëm. Kjo strukturë:

1. Identifikon kërkesat e audituesve të brendshëm për trajnime, në formë dhe në përmbajtje me qëllim Hartimin e Programit Vjetor të Trajnimit të Vijueshëm të Detyrueshëm.
2. Harton çdo vit Programin e Trajnimit të Vijueshëm të Detyrueshëm si pjesë përbërëse e Planit Vjetor të Konsoliduar të Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm të hartuar nga NJQH/AB, i cili miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

#### **Neni 8**

Programi i Trajnimit të Vijueshëm të Detyrueshëm duhet të përfshijë:

- Temat e identifikuara për trajnim dhe orët/ditët e nevojshme për zhvillim të secilës prej tyre;
  - Qëllimin dhe objektivat për çdo temë trajnimi;
  - Format e organizimit të trajnimit;
  - Grupet e synuara për pjesëmarrje në trajnim;
  - Numrin maksimal të personave pjesëmarrës në çdo veprimtari trajnuese
- Njësia Qëndrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm publikon në faqen e internetit të Ministrisë së Financave Programin e miratuar si dhe njofton të gjitha Njësitë e Auditimit në subjektet publike për veprimtaritë e parashikuara, jo më vonë se 3 (tre) muaj para fillimit të tyre.

### **Neni 9**

Trajnerët për zbatimin e Programit të Trajnimit të Vijueshëm të Detyrueshëm do të përzgjidhen sipas kriterëve të përgjithshme sa më poshtë:

Të kenë përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga të cilat 3 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm dhe/ose fusha të tjera profesionale specifike në përputhje me trajnimin që do të japë;

1. Të këtë përvojë në trajnime profesionale dhe/ose mësimdhënie akademike, jo më pak se dy vjet në fushën që do të zhvillojë trajnim, e vërtetuar me dokumentacionin përkatës;
2. Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese dhe informuese për transmetimin e dijeve tek pjesëmarrësit të vëretetuar me vlerësimin nga punëdhënësi dhe referencat përkatëse;

Procedura dhe mënyra e përzgjedhjes bëhet në përputhje me nenin 6, të Rregullores “Për procedurat e çertifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik”.

### **Neni 10**

Në përputhje me Programin e Trajnimit të miratuar, trajnerët e përzgjedhur për çdo temë trajnimi përgatisin dhe paraqesin për miratim përmbajtjen e temës të trajtuar me përshkrim (në word) dhe prezantimin (në ppt). Materialet e trajnimit dorëzohen në NJQH për AB brenda afateve të përcaktuara prej saj.

### **Neni 11**

Njësia Qendrore e Harmonizimit grumbullon materialet e përgatitura të trajnimit, dhe pas miratimit i bën të vlefshme për përdorim për të gjithë pjesëmarrësit në trajnim.

### **Neni 12**

Njësia Qendrore e Harmonizimit mund të rishikojë Programin e Trajnimit sipas nevojave dhe propozimeve të strukturave audituese. Pas rishikimit të Programit, procedurat e zbatimit të tij nuk ndryshojnë.

### **Neni 13**

Pas shpalljes se Programit të Trajnimit të Vijueshëm të Detyrueshëm, Njësia Qendrore e Harmonizimit për AB përcakton listën e pjesëmarrësve, grafikun,

oraret dhe vendin e zhvillimit të trajnimit, i cili publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Financave.

#### **Neni 14**

Stafi përgjegjës për trajnimin në NJQH për AB komunikon dhe mban kontakte të vazhdueshme me trajnuesit e përzgjedhur, mirëmban dhe administron bazën materiale dhe mjedisin e trajnimit për të siguruar vazhdimësinë e zbatimit të programit sipas parashikimeve.

### **IV. Monitorimi dhe raportimi**

#### **Neni 15**

Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm ndjek dhe monitoron në vijimësi zbatimin e Programit të Vijueshëm të Detyrueshëm. Veprimtaritë e trajnimit, temat e zhvilluara dhe pjesëmarrja në trajnim evidentohen në evidencat e miratuara për këtë qëllim.

Njësia Qendrore e Harmonizimit pasqyron informacionin në Regjistrin e Audituesve të Brendshëm dhe monitoron zhvillimin profesional të çdo audituesi lidhur me shlyerjen e detyrimeve për trajnimet e detyrueshme. Monitorimi i zhvillimit profesional do të përfshijë audituesit e brendshëm në detyrë dhe audituesit e brendshëm të certifikuar.

#### **Neni 16**

Në përfundim të çdo sezoni trajnimi, NJQH për AB bën vlerësimin e performancës së procesit nëpërmjet formularëve të “Vlerësimit të Performancës së Trajnimit” të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Të dhënat e grumbulluara pasqyrohen në Raportin e Vlerësimit të Trajnimit i cili publikohet apo është pjesë e Raportit Vjetor të Veprimtarisë së NJQH për AB.

### **V. Dispozita kalimtare**

#### **Neni 17**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 Janar 2013. Parashikimet lidhur me Raportimin në nenin 15 do të zbatohen nga 1 Janari 2014 për vitin e mëparshëm.